

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

UJESJELLES-KANALIZIME SH.A- SARANDE

Sarande, me 01.12.2020

Për : BOE "I.C.C GROUP" shpk NIPT L51308006A dhe
"2Z KONSTRUKSION" shpk NIPT J63229466K

Procedura e prokurimit : E hapur

Numri i references se procedures : REF-72344-09-21-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës : **"Ndertim i Kanalizimeve te Ujrave te Zeza ne Bllokun mbi Rrugen Nr.5, Lagjia nr.3, Sarande"**

Fondi limit : **32,039,144 (tridhjet e dymilion e tridhjet e nendemije e njeqind e dyzet e kater) leke pa tvsh**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët

Publikime të mëparshme : **Buletini i Njoftimeve Publike nr. 77, date 28 Shtator 2020**

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:

1. "FLED" shpk NIPT K17621104C me oferte 22,204,150 leke pa TVSH
2. "SHENDELLI" shpk NIPT K07924803N me oferte 22,785,530 leke pa TVSH
3. "MANE/S" shpk NIPT J64103865K me oferte 25,169,020 leke pa TVSH
4. BOE "I.C.C GROUP" shpk NIPT L51308006A dhe "2Z KONSTRUKSION" shpk NIPT J63229466K me oferte 31,821,600 leke pa TVSH
5. "ENGLAND" shpk NIPT J96829419D **nuk ka dorezuar ofert ekonomike**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te 4 OE qe kane paraqitur oferte ekonomike, rezultoi se 3 prej OE nuk i plotesonin kerkesat dhe kushtet e DST-se te hartuar nga AK.

Nga sa me siper KVO-ja konkludoi se:

1. **Operatori Ekonomik FLED shpk**

Kriteret e Vecanta te Kualifikimit

1. Per Piken 2.3.1

Nisur nga dokumentacioni i paraqitur nga OE "FLED" shpk rezulton se:

Shoqeria "FLED" shpk ka paraqitur dokumentacion e kërkuar sipas pikës 2.3.1 per punët e ngjashme.

1. “Mbrojtja Lumore ne Velabisht.
2. “ Rikonstruksion i kanalit ujitës Cerrage”.
3. “Rehabilitim i skemës ujitëse Ure Vajgurare-Poshnje”.
4. “Rikonstruksioni i Rruges Enver Bregu Kucove”

Nga shqyrtimi i dokumentacionit ne brendësi per këto objekte rezulton se:

Se Objektet nr.1 , 2, dhe 3, nuk kane per natyre te punes se ngjashme objektin e prokuruar nga AK, pasi ne natyre te këtyre objekteve nuk eshte puna e ngjashme per ujësjellësa apo kanalizime te ujrave te zeza .

Ndersa per Objektin Nr.4, Ky objekt nuk ka per natyre te punës se ngjashme objektin e prokuruar nga AK, por nëse analizon zërat vec e vec, ne situacioni e paraqitur nga OE, rezulton te jene kryer punime te kanalizimeve per ujrave te zeza. Kete objekt OE “Fled” shpk e ka realizuar ne bashkëpunim me shoqerin “ Shkelqimi 07” shpk, me te cilën ka kontrate bashkëpunimi ku ka marre përsipër realizimin e 51% te punimeve apo përkthyer ne vlere monetare **51% e 29,461,240** vlere pa TVSH e kontrates ose **15,025,232 lek pa TVSH vlere e cila eshte realizuar nga ku OE.**

Si rezultat ky OE me dokumentacionin e dorezuar nuk arrine te përmbushe kërkesat e pikës **2.3.1 a) dhe b)**

Sa më sipër, KVO vlerëson se OE nuk vërteton se gëzon eksperiencë të mëparshme në përputhje me kriteret dhe kushtet e përcaktuara ne piken a) dhe b) te pikës 2.3.1. te “Kritereve te Veçanta” te hartuar nga AK.

2. Per Piken 2.3.2

Per kete pike OE nuk ka dorezuar asnjë dokumente per te përmbushur kete pike, pra **“Licenca e Zbatimit”** te shoqërisë, nga shqyrtimi i gjithë dokumentacionit te dorëzuar nga OE, **ky dokument mungon.**

3. Per Piken 2.3.3

Per te përmbushur kete kriter OE ka dorezuar Liste Pgesen e Shqoerise per muaj Gushte, por me ndryshimet ne **“Shtojcen nr.1”** te hartuar nga AK, kërkohet te paraqitet **“Liste Pagesa”** per periudhën **muaj i fundit i deklarimit i cili eshte Shatatori .**

4. Per Piken 2.3.5 d)

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te dorezuar nga OE, rezulton se per përmbushjen e kësaj pike janë dorezuar dokumenta ne përputhje me kerksat e hartuar nga AK nga OE, vetëm per **Teknikun e Ndërtimit**, ndërsa per specialistet e tjerë Tek.Hidrulik, Saldator, Hdraulik, Karpentier, Hekurkthues janë dorëzuar dokumentacionet si kontratat personale te këtyre punonjësve dhe deshmit e kualifikimit te sigurmit teknik, dhe asnjë dokumentacion tjetër per te **dëshmuar kualifikimin profesional, si certifikat, deftes, apo certifikata trajnimi** te akredituara nga institucione shqipetare.

5. Per Piken 2.3.8

OE nuk e permbushë kete pike pasi per mjetet e kërkuara si 1.Sharre Punimi metali, 2. Depozit grumbullimi matrialesh, 3. GPS, 4. Pirun, 5, Helikopter nuk ka dorëzuar asnjë dokumentacion per te vërtetuar se ka ne pronësi apo me qera.

Per me tepër nga shqyrtimi i dokumentacionit te paraqitur nga OE, rezulton se mungon 1 Kamion 3.5-7.5 ton nga 3 te kerkuar ne DST-ne e hartuar nga AK si dhe per mjetet Skrep mungon 1 prej tyre nga 3 te kërkuar, pasi kontrat e qirasë me z.Altin Marra skadon me dt.22.11.2020 ne kundërshtim me kërkesën a) te kësaj pike, dhe mjeti tjetër ekskavator me goma per te cilin OE ka kontrate qiraje AGMT30 ka skaduar siguracioni dhe kontrolli teknik ne date18.09.2020.

6. Per Piken 2.3.10

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te dorëzuar nga OE rezulton se:

OE nuk ka paraqitur **asnjë Certifikat te cilësisë te Punimve** qe OE ka marre përsipër per te realizuar per ISO 1452-1:2009 (Standart per Sistemet e tubacioneve Plastike per furnizim me uje) si dhe ISO 333/2011 (Menaxhimi i Hekurit)

Nga sa me siper dhe ne mbeshteje te Ligji te Prokurimit Publik Nr. 9643, datë 20.11.2006 te ndryshuar me Ligjin Nr. Ligjin Nr.103/2018, Neni.46 dhe Neni 55, KVO-ja konkludon se, oferta e OE “FLED” shpk, nuk eshte e suksesshme, pasi nuk permbushen te gjitha kriteret dhe kërkesat sipas DST-se te hartuar nga AK.

2. Operatori Ekonomik “SHENDELLI” shpk

Kriteret e Pergjitheshme te Kualifikimit

Vertetimi per Kontribut e sigurmet shoqerore dhe shendetesore te OE per dt.18.10.2020 rezuton te jete me detyrime pasi ky subjekt ka per te paguar vlerën e prapambetur prej 574,046 lek pa TVSH.

Kriteret e Vecanta te Kualifikimit

1. Per Piken 2.3.1

Nisur nga dokumentacioni i paraqitur nga OE “SHENDELLI” shpk rezulton se:

Shoqeria “SHENDELLI” shpk ka paraqitur dokumentacion e kërkuar sipas pikës 2.3.1 per punët e ngjashme.

1. “Rehabilitim Kanali Ujites Gusmar”.
2. “Punime Mirembajtje Kanali Vadites Peqin Kavaj”.
3. “Rehabilitim i sistemit Ujites Roskovec”.
4. “Kodra e Shtufit”
5. “Rruga Berat -Morave”

Nga shqyrtimi i dokumentacionit ne brendësi rezulton se:

Se Objektet nr.1 , 2, dhe 4, nuk kane per natyre te punes se ngjashme objektin e prokuruar nga AK, pasi ne natyre te këtyre objekteve nuk eshte puna e ngjashme per ujësjellësa apo kanalizime te ujrave te zeza .

Puna e ngjashme nr.3 eshte realizuar jashtë 3 viteve te fundit sic eshte e përcaktuar ne piken 2.3.1, si rezultat nuk munde te jete pune e ngjashme apo te kualifikohet si e till.

Ndersa per Objektin Nr.5, Ky objekt nuk ka per natyre te punës se ngjashme objektin e prokuruar nga AK, por nëse analizon zërat vec e vec, ne situacioni e paraqitur nga OE, rezulton te jene kryer punime te kanalizimeve per ujrave te zeza ne vlerën **1,967,803 lek pa TVSH e cila eshte shume me e vogël se 50% e vlers se përlogaritur te fondit qe prokurahet..**

Si rezultat ky OE me dokumentacionin e dorzuar nuk arrine te përmbushi kërkesat e pikës **2.3.1 a) dhe b)**

Sa më sipër, KVO vlerëson se OE nuk vërteton se gëzon eksperiencë të mëparshme në përputhje me kriterin dhe kushtet e përcaktuara ne piken a) dhe b) te pikës 2.3.1. te “Kritereve te Veçanta” te hartuar nga AK.

2. Per Piken 2.3.2

Per te përmbushur kete kriter OE ka dorezuar Liste Pgesen e Shqerise per muaj Gushte, por me ndryshimet ne **“Shtojcen nr.1”** te hartuar nga AK, kërkohet te paraqitet **“Liste Pagesa”** per periudhën **muaj i fundit i deklarimit i cili eshte Shtatori** . Per muajin Shtator eshte dorëzuar vetëm Vertetimi nga tatimet i numrit te punonjësve i cili figuron me detyrime.

3. Per Piken 2.3.4

OE nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar per **Inxhinierin e Mjedist**, per te përmbushur kete pike. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se nuk figuron **Inxhinier Mjedisi** me kontrat dhe diplome.

4. Per Piken 2.3.5 a)

Nga shqyrtimi dokumentacionit te dorëzuar nga OE rezulton se, shoqeria nuk ka te punësuar asnjë punonjës si **(Pergjegjes per Demin ne Mjedis)** te cilin duhet ta vërtetoj me certifikatën përkatëse trajnuese si dhe te figuroj ne listepagesen e shoqerise per muajin e fundit.

5. Per Piken 2.3.6

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te paraqitur nga OE rezulton se mjekut **Dashnor Yzeiraj**, i ka mbaruar **Licenca** e ushtrimit individual te profesionit me date 14.10.2020.

6. Per Piken 2.3.8

OE nuk e permbush kete pike pasi per mjetet e kërkuara si, 1. Depozit grumbullimi matrialesh, 2. Pirun, 3, Helikopter nuk ka dorëzuar asnjë dokumentacion per te vërtetuar se ka ne pronësi apo me qera.

Ndersa per Mjetin Autobot me te cilën shoqëria ka kontrat me shoqerin **“JODY COMPANY”** siguracioni i mjetit ka mbaruar me **dt.23.08.2020**.

Mungon 1 Skrep nga 3 te kërkuar përveç mjeteve **AGMT67 dhe AMT30**.

Nga shqyrtimi dokumentacionit dorëzuar nga OE rezulton se per plotësimin e kerkese **“Tokmak Ngjeshes dheu”** OE ka paraqitur **“RUL” dhe jo tokmak**.

7. Per Piken 2.3.10

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te dorëzuar nga OE rezulton se per përmbushjen e kësaj pike OE nuk ka dorëzuar asnjë dokumentacion per te vërtetuar se ka **Certifikatat e cilësisë te punimve**, te kërkuara per përmbushjen e kësaj pike.

Nga sa me siper dhe ne mbeshteje te Ligji te Prokurimit Publik Nr. 9643, datë 20.11.2006 te ndryshuar me Ligjin Nr. Ligjin Nr.103/2018, Neni.46 dhe Nenit 55, KVO-ja konkludon se, oferta e OE “SHENDELLI” shpk, nuk eshte e suksesshme, pasi nuk permbushen te gjitha kriteret dhe kërkesat sipas DST-se te hartuar nga AK.

3. Operatori Ekonomik “MANE/S” shpk

Kriteret e Vecanta te Kualifikimit

1. Per Piken 2.3.8

Nga shqyrtimi i dokumentacionit per përmbushjen e kësaj pike, rezulton se ka problematikat e meposhtme :

1. Per Mjetin Kamioncine

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te paraqitur nga OE rezulton se mungon 1(nje) kamioncine, pasi mjeti **SR 5513B** i mbarone kontrata ne **dt 11.12.2020** ne kundershitm me kërkesat e pikes 2.3.8 a).

Per përmbushjen e kësaj pike eshte paraqitur dhe dokumentacion per mjetin **AA274 TE** me te cilin OE ka kontrat qiraje te vlefshme me shoqërinë “**Anxhelo-Br 2007**”, por rezulton se ky mjete eshte me tonazh mbi 1.5 ton dhe ne te gjithë dokumentacionin shoqërues ky mjet figuron si mjet i llojit “**KAMION**” dhe ja mjet i llojit “**ATP**” me te cilën përcaktohet kamionçina..

2. Per mjetin Autobot shoqëria ka paraqit dokumentacionin si certifikat pronësie, SGS, Siguracion, Lejeqarkullimi, Certifikat transporti ne te cilat ky mjet **nuk figuron i llojit “ATV”**, por mjetet Autobote shoqërohen dhe me **Pasaporte Verifikimi** lëshuar nga drejtoria e pergjitheshme e metorologjise per konfirmin e llojit te mjetit dhe ngarkese qe mbanë ky mjet, per me tepër ne foto ky mjet rezulton te jete nje autovinq ngarkuar ne karaoceri nje depozite uji.

3. Per mjetin Eskavtor me Goma, shoqëria ka dorzuar kontratën e qirase qe ka me z.Muharem Qerimi dhe faturat e zhdoganimit. Kerkohet ne legjislacioni shqiptar qe te gjitha mjete qe janë me goma dhe lëvizin ne rruge automobilistike te regjistrohen ne regjistrat publik dhe te paisen me dokumentacionin perkates. Objekti qe eshte prokuruar do te realizohet ne lagje ekzistuese te qytetit te Sarandes ku shume pjese qe do te kryhet ndërhyrja ka rruge automobilistike. Pra mjeti i kërkuar eshte pa certifikat pronësi, Kontroll Teknik, Taksa dhe Siguracion.

4. Per mjetin “Share per Punim metali” per kete mjet OE nuk ka dorëzuar dokumentacion. Ne kontratën e qirasë qe OE ka me shoqërinë “Elal Com” figuron mjeti te jete **Mkineri prerëse metalesh me kontroll numerik** e cila sipas fotos te paraqitur eshte e stacionuar ne ambiente dhe **jo sharre punimi metali e cila eshte e levizeshme** dhe perdoreshme ne terren ku do te realizohet objekti.

Nga sa me siper dhe ne mbeshteje te Ligji te Prokurimit Publik Nr. 9643, datë 20.11.2006 te ndryshuar me Ligjin Nr.103/2018, Neni.46 dhe Neni 55, KVO-ja konkludon se, oferta e OE “MANE/S” shpk, nuk eshte e suksesshme, pasi nuk permbushen te gjitha kriteret dhe kërkesat sipas DST-se te hartuar nga AK.

4.. Operatori ekonomik “ENGLAND” shpk NIPT J96829419D nuk ka dorezuar oferte ekonomike

Nga sa me siper dhe ne mbeshtetje te Ligjit te Prokurimit Publik Nr. 9643, datë 20.11.2006 te ndryshuar me Ligjin Nr.103/2018, Neni.46 dhe Neni 55, KVO-ja konkludon se, OE “ENGLAND” shpk, nuk permbush kriteret dhe kërkesat sipas DST-se te hartuar nga AK.

Duke u nisur nga sa me siper renditja e operatoreve ekonomik eshte si me poshte:

- | | |
|--|---------------------|
| 1. “FLED” shpk Nipt. K17621104C | Skualifikuar |
| 2. “Shendelli” shpk Nipt. K07924803N | Skualifikuar |
| 3. “MANE/S” shpk Nipt. J64103865K | Skualifikuar |
| 4. BOE “I.C.C GROUP” shpk dhe “2Z KONSTRUKSION” shpk | Kualifikuar |
| 5. “ENGLAND” shpk Nipt. J96829419D | Skualifikuar |

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Shoqerite **BOE “I.C.C GROUP” shpk** me NIPT L51308006A, Adresa : TIRANE Njesia bashkiake Nr.4, Rruga 5 Maji, Kompleksi AREELA, Pallati 2, Shkalla 1, Apartamenti 21 dhe **“2Z KONSTRUKSION” shpk** me NIPT J63229466K, Adresa : Fier Roskovec Strum Fshati Suke i siperme, Nr 2, Rruga Strum - Suke, Km 3, Lagjja Zoga, se oferta e paraqitur me vlere :

31,821,600(tridhjetë e njemilion teteqind njezet e njemije e gjashteqind), leke pa tvsh

është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Ujesjelles Kanalizime sh.a Sarande* kopjen e sigurimit të kontratës, si dhe te paraqiteni per nenshkrimin e kontrates, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë më datë **05.11.2020**

Ankesa : Me date 10.11.2020 ka paraqitur ankese OE “MANE/S” shpk, lidhur me s.kualifikimin e tij.

Nga ana e Titullarit te AK u vendos pezullimi i procedures se prokurimit dhe u ngrit Komisioni per shqyrtimin e ankeses.

Komisioni i shqyrtimit te ankeses, pasi shqyrtoi ankesen e paraqitur nga OE "MANE/S" shpk, me date 16.11.2020 vendosi te leje ne fuqi vendimin e KVO per s.kualifikimin e tij, vendim i cili iu komunikua ketij OE me email ne adresen e deklaruar tek formulari i ankeses, me date 16.11.2020.